

9

ADHURIMI NË KISHËN E JEZUSIT (I)

Në qoftë se organizimi është skeleti i trupit, adhurimi është zemra. “Adhuro Zotin, Perëndinë tënde, dhe shërbeji vetëm atij” (Mateu 4:10).

Dy aspekte të rëndësishme të adhurimit janë se *çfarë* bëjmë gjatë adhurimit dhe *mënyra* si e bëjmë. Jezusi i tha një gruajë samaritane: “Por po vjen ora, madje ajo ka ardhur, që adhuresit e vërtetë ta adhurojnë Atin në frymë dhe në të vërtetën, sepse të tillë janë adhuresit që kërkon Ati. Perëndia është Frymë, dhe ata që e adhurojnë duhet ta adhurojnë në frymë dhe në të vërtetën” (Gjoni 4:23, 24). Ta adhurosh Perëndinë “në frymë” do të thotë ta adhurosh në zemër. Adhuresit e vërtetë mendojnë për atë që po bëjnë. Ata i drejtojnë mendimet e tyre në drejtim të qiellit. Ta adhurosh Perëndinë në “të vërtetën” do të thotë ta adhurosh atë siç ai ka thënë në Fjalën e tij, sepse Jezusi tha se Fjala e Perëndisë “është e vërteta” (Gjoni 17:17).

Në këtë mësim dhe në atë që pason, do të shqyrtojmë çfarë Shkrimet mësojnë për adhurimin në kishën e Jezusit. Ndërsa e bëjmë këtë, do të theksojmë se “çfarë” bëhet në adhurim dhe “si” adhurohet. Adhurimi i Perëndisë duhet të përfshijë jo vetëm veprimet e drejta, por edhe qëndrimet e drejta.

DITA E VEÇANTË E ADHURIMIT

Mund ta adhurojmë Perëndinë në çdo ditë të javës. Në vitet e para të jetës së kishës, kristianët mblidheshin çdo ditë (Veprat 2:46). Megjithatë Dhjata e Re na mëson se është një ditë e veçantë e javës në të cilën të gjithë kristianët duhet të mblidhen për të adhuruar.

Në Dhjatën e Vjetër, dita e veçantë e adhurimit ishte dita e shtunë, e cila ishte dita e shtatë e javës

(Eksodi 20:10, 11). Për kristianët dita e veçantë është dita e parë e javës, e diela. Kjo ishte dita në të cilën Krishti u ngrit prej së vdekurish (Mateu 28:1, 6). Kjo ishte dita në të cilën kristianët e parë mblidheshin (1 Korintasve 16:2), dita kur ata merrnin Darkën e Zotit (Veprat 20:7). E diela është quajtur “dita e Zotit” (Zbulesa 1:10).¹

Do të studiojmë pesë shprehjet e adhurimit. Tri prej këtyre mund të bëhen çdo ditë, studimi i Biblës, lutja dhe të kënduarit. Dy prej tyre, Darka e Zotit dhe kontributi, lidhen vetëm me ditën e parë të javës (të dielën).

MËNYRAT E ADHURIMIT**Darka e Zotit**

Shprehja e parë e adhurimit që do të trajtojmë është Darka e Zotit. Gjatë festës së tij të fundit të Pashkëve² me dishepujt e tij, Jezusi themeloi Darkën e Zotit.

... Zoti Jezus, në atë natë që po tradhëtohej, mori bukën dhe, si falënderoi, e theu dhe tha: “Merrni, hani; ky është trupi im që është thyer për ju; bëni këtë në përkujtimin tim.” Gjithashtu, pas darkës, mori edhe kupën, duke thënë: “Kjo kupë është besëlidhja e re në gjakun tim; bëni këtë sa herë që të pini, në përkujtimin tim.” Sepse sa herë të hani nga kjo bukë ose të pini nga kjo kupë, ju shpallni vdekjen e Zotit, derisa ai të vijë. Prandaj ai që ha nga kjo bukë ose pi nga kjo kupë e Zotit padenjesisht,³ do të jetë fajtor i trupit dhe i gjakut të Zotit. Por secili le të shqyrtojë vetveten dhe kështu të hajë nga buka e të pijë nga kupa (1 Korintasve 11:23–28).⁴

Në themelimin e Darkës, Jezusi përdori bukë pa maja⁵ dhe frutin e hardhisë.⁶ Pjesëmarrësit në festimin e parë të Darkës morën edhe bukën edhe frytin e hardhisë.⁷

Kur Jezusi tha: “Ky është trupi im” ai nuk deshi të thoshte se buka ishte shndërruar në mënyrë magjike dhe misterioze në mishin e tij. Ai po qëndronte para tyre, i tëri në mish. Ai donte të thoshte atë që them unë kur marr një fotografi nga muri dhe them: “Këta janë nipat e mi.” Fotografia përfaqëson nipat e mi. Në të njëjtën mënyrë, buka pa maja përfaqëson trupin e Krishtit dhe fryti i hardhisë përfaqëson gjakun e tij.

Darka e Zotit, në Bibël, quhet “pjesëmarrje” (1 Korintasve 10:16) apo “tryeza e Zotit” (1 Korintasve 10:21). Meqënëse fillon me thyerjen e bukës pa maja nga adhuruesit, kjo shprehje e adhurimit njihet gjithashtu si “thyerja e bukës”.⁸ Kristianët e parë “ishin ngulmues . . . në thyerjen e bukës . . .” (Veprat 2:42).

Kisha e Dhjatës së Re mori pjesë në Darkën e Zotit në ditën e parë të javës, të dielën. Kisha mbledhesh çdo ditë të parë të javës (shiko 1 Korintasve 16:1, 2). Shërbimi i tyre përqëndrohej rreth kremtimit të Darkës së Zotit. Te Veprat 20, lexojmë se Pali, Luka dhe të tjerë arritën në Troas. Luka më vonë shkroi: “Ditën e parë të javës, kur ishin mbledhur dishepujt për të thyer bukën, Pali i cili duhej të nisej të nesërmen, bisedonte me ta . . .” (Veprat 20:7). Kur bashkësia në Troas mbledhesh në ditën e parë të javës (të dielën), qëllimi parësor i tyre ishte që të thyenin bukën. Shkrime të autorëve kristianë në shekujt e parë të jetës së kishës tregojnë se kjo vazhdoi të praktikohet për shumë vite. Ndërsa kristianët mbledheshin në çdo ditë të parë të javës, fokusi parësor ishte mbi Darkën e Zotit.

Për të kënaqur Perëndinë në marrjen e Darkës së Zotit, është e rëndësishme të bëjmë gjërat e duhura. Kristianët duhet të marrin edhe bukën pa maja edhe frytin e hardhisë dhe duhet ta bëjnë këtë në ditën e parë të çdo jave. Është gjithashtu e rëndësishme marrja pjesë me mënyrën e duhur. Adhuruesit duhet t’i përqëndrojnë mendimet e tyre në sakrificën e Jezusit dhe në atë se çfarë do të thotë për ta sakrificat e tij. (Lexoni edhe një herë 1 Korintasve 11:26–29.)

Fjala e Perëndisë

Kur kisha në Troas u mbledh për të marrë Darkën e Zotit, Pali u foli atyre për vullnetin e Perëndisë (Veprat 20:7).⁹ Predikimi apo mësimi i Fjalës së Perëndisë është një mënyrë e rëndë-

sishme për t’iu afruar Perëndisë. Kisha e hershme mbledhesh shpesh për të dëgjuar fjalën e lexuar apo të diskutuar (Veprat 2:42; Kolosianëve 4:16).

Bibla vendos disa kufizime në predikimin gjatë adhurimit në bashkësi të dielave. Duhet predikuar Fjala e Perëndisë dhe jo opinionet apo filozofitë e njerëzve (2 Timoteut 4:1–4).¹⁰ Vetëm burrat duhet të predikojnë apo mësojnë në mbledhjet publike (1 Korintasve 14:34).¹¹

Megjithatë, nuk është e mjaftueshme thjesht të shikosh si spektator apo gjykatës se “çfarë” duhet të predikohet apo mësohet biblikisht. Fakti se një predikues po bën një predikim të kënaqshëm për Perëndinë nuk garanton se çdonjëri prej dëgjuesve të tij po adhuron. Adhurimi duhet të bëhet në zemrën e dëgjuesve. Secili që është prezent duhet të marrë pjesë në shërbimin e predikimit duke dëgjuar me kujdes dhe duke i vënë në zbatim mësimet e ardhura nga Fjala e Perëndisë nëpërmjet këtij predikimi.

Lutja

Një pjesë e rëndësishme e adhurimit është lutja. Pali u tha kristianëve në Thesaloniki: “Lutuni pa pushim” (1 Thesalonikasve 5:17). Dikush ka thënë se, kur lexojmë Biblën, Perëndia na flet dhe, kur lutemi, ne i flasim Perëndisë. Në Dhjatën e Re, kur kristianët mbledheshin bashkë, ata luteshin (Veprat 2:42; 4:23, 24; 6:6; 12:12).

Lutja është një pjesë e pandashme si e adhurimit publik, ashtu edhe e adhurimit privat. Çdo kristian duhet të lutet vazhdimisht (Mateu 6:5–15; 14:23; Luka 5:16; Veprat 10:9; 16:25).

Adhurimi publik në përgjithësi përfshin disa lutje që drejtohen nga burrat në bashkësi. Pali shkroi: “Dua, pra, që burrat të luten në çdo vend, duke ngritur duar të pastra, pa mëri dhe pa grindje” (1 Timoteut 2:8). Vetëm burrat duhet të drejtojnë lutjet në shërbesat e adhurimit në bashkësi.

Edhe lutja mund të bëhet pa adhurim të vërtetë. Drejtuesi i lutjes duhet të jetë i ndërgjegjshëm për prezencën e Perëndisë dhe t’i drejtojë mendimet te Perëndia dhe jo te njerëzit. Ata që marrin pjesë në lutje duke dëgjuar, duhet ta ndjekin lutjen në zemrat e tyre dhe të shtojnë kërkesat dhe falënderimet e tyre. Pastaj ata mund të thonë “amen” (me zë apo pa zë) dhe ta thonë atë me gjithë mend (1 Korintasve 14:16; shikoni gjithashtu Mateu 6:13; Romakëve 16:27 dhe

Efesianëve 3:21).¹²

Kontributi

Një mënyrë për të shprehur mirënjohje ndaj Perëndisë është dhënia e kontributit¹³ (ofertës së lirë), në ditën e parë të çdo jave. Pali i tha kishës në Korinth:

Sa për të mbledhurit e ndihmave për shenjtorët, bëni edhe ju ashtu si i urdhërova kishat e Galatisë. Të parën ditë të çdo jave, secili nga ju le të vërë mënjanë aq sa mundet,¹⁴ sipas të ardhurave të tij, që, kur të vij, të mos bëhen atëherë mbledhje ndihmesh (1 Korintasve 16:1, 2).

Dhjata e Vjetër përcaktonte një përqindje të caktuar për t'u dhënë nga adhuruesit, 10 për qind të asaj që ata kishin. Kjo quhej “e dhjetë” (Levitiku 27:30; Ligji i Përtërirë 14:22; Malakia 3:8–10). Dhjata e re nuk specifikon një përqindje të caktuar për t'u dhënë nga kristianët. Përkundrazi, ajo mëson se ata duhet të japin me dëshirë, me zemërgjerësi dhe me gëzim (2 Korintasve 9:6, 7), sipas të ardhurave të tyre (1 Korintasve 16:2). Njoh kristianë që japin 10 përqind apo edhe më shumë prej të ardhurave të tyre, por e bëjnë këtë nga mirënjohja dhe jo nga shtrëngimi.

Dikush mund të japë “me bollëk” dhe megjithatë të mos adhurojë. Ndërsa adhuruesi jep kontributin e tij, ai duhet të lutet duke e falënderuar Perëndinë për bekimet që ka marrë dhe t'i kërkojë Perëndisë që ta pranojë dhuratën e tij.

Të kënduarit

Shprehja e pestë e adhurimit është të kënduarit. Pali e urdhëroi kishën në Kolose: “Fjala e Krishtit banoftë në ju me begatinë e vet; në çdo dituri, mësoni dhe këshilloni njëri tjetrin me psalme, himne dhe këngë frymërore, duke i kënduar Zotit me hir në zemrat tuaja” (Kolosianëve 3:16). Do ta lëmë trajtimin e të kënduarit për mësimin “Adhurimi në kishën e Jezusit”, por vargjet e mësipërme theksojnë se “çfarë” bëhet në adhurim: “mësoni dhe këshilloni njëri tjetrin me . . . himne” dhe “duke i kënduar Zotit”. Ato gjithashtu theksojnë “si” të adhurojmë: “me hir në zemrat tuaja”.

RËNDËSIA E ADHURIMIT

Kemi trajtuar mësimin e Dhjatës së Re për adhurimin, me theks në adhurimin publik. Tani lind pyetja: “A është thelbësore të mblidhemi

bashkë për të adhuruar?” Shumë mendojnë se pjesëmarrja rregullisht në shërbimet e adhurimit është e parëndësishme. Çfarë na mëson Bibla? Disa çuditën kur mësojnë se Perëndia ka folur për këtë çështje.

Libri i Hebrenjve u shkrua për kristianët që dikur kishin qenë besnikë (Hebrenjve 10:32–34). Për disa arsye ata ishin bërë indiferentë dhe moskokëçarës (Hebrenjve 2:3). Kjo përfshinte edhe pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet publike të kishës (10:25). Atyre u ishte thënë “të kujdeseshin për njëri tjetrin, për t'u nxitur për dashuri dhe vepra të mira” (10:24). Një mënyrë për ta bërë këtë ishte që ta inkurajonin njëri tjetrin kur mblidheshin bashkë. Kështu lexojmë këto fjalë: “*Pa hequr dorë nga të mbledhurit bashkë tonin, sikurse kanë zakon disa, por të nxisim njëri tjetrin, aq më tepër se e shihni ditën që po afrohet*” (10:25). Për njerëzit sot, “dita që po afrohet” është ardhja e dytë e Jezusit.¹⁵ Krishti mund të vijë në çdo kohë, kështu që duhet të jemi gjithmonë gati (Mateu 25:13).

Ata që bëhen të parregullt në pjesëmarrjen adhurimin në bashkësi, zakonisht bëhen të parregullt edhe në fusha të tjera të jetës kristiane. Hebrenjve 10:26–31 na paralajmëron për këtë:

Sepse, në qoftë se ne mëkatojmë me dashje mbasi kemi marrë dijëni të së vërtetës, nuk mbetet më asnjë flijim për mëkatet, por vetëm një pritje gjyqi e tmerrshme dhe një e ndezur zjarri që do të përpijë kundërshtarët. Kushdo që shkel ligjin e Moisiut vritet pa mëshirë me deponimet e dy ose tre dëshmitarëve. Ç'dënim më të keq meriton, sipas mendimit tuaj, ai që ka shkelur me këmbë Birin e Perëndisë dhe e ka konsideruar profan gjakun e Besëlidhjes me të cilin u shenjtërua, dhe ka fyer Frymën e hirit? Sepse ne e dimë atë që ka thënë: “Hakmarrja më takon mua, unë do ta jap shpagimin”, thotë Perëndia. Dhe përsëri: “Perëndia do të gjykojë popullin e vet”. Gjë e tmerrshme është të bjerë njeriu në duart e Perëndisë së gjallë.

Kemi lexuar te Shkrimet se kristianët duhet ta marrin Darkën e Zotit të dielën, ditën e parë të çdo jave. Shumica e bashkësive kanë mbledhje të rregullta edhe gjatë javës për qëllime ndërtimi dhe bashkësie me njëri-tjetrin. Ai që i ka dhënë jetën Krishtit do të donte të merrte pjesë në të gjitha takimet që do të mundej. Ato do të nxisnin në rritjen si kristian dhe do ta ndihmonin të qëndronte i fokusuar në atë që është me të vërtetë e rëndësishme.

KONKLUZION

Keni mësuar mjaft nga mësimet e Dhjatës së Re për adhurimin, aq sa mund të formuloni pyetje për t'i përdorur në shqyrtimin e grupeve të ndryshme fetare. Për shembull, mund të pyesni: “A e marrin darkën e Zotit të dielën, ditën e parë të javës?”; “A janë predikuesit e atij grupi shpallës besnikë të fjalës së Perëndisë?”; “A drejtojnë vetëm burrat në adhurim?”

Ndërsa bëni shqyrtimin e këtyre grupeve, mos lini pas dore shqyrtimin e zemrës tuaj. Pyesni veten: “A më pëlqen të adhuroj Perëndinë së bashku me kristianë të tjerë?”; “Kur mblidhem me vëllezërit dhe motrat kristianë për adhurim, a jam gati të adhuroj?”; “Kur jam atje, a adhuroj me të vërtetë?”¹⁶ Këto janë pyetje të rëndësishme.

¹ Shkrimtarë të hershëm, jo të frymëzuar nga Perëndia, konfirmuan se Gjoni po fliste për ditën e parë të javës kur përdori frazën “dita e Zotit”.

² Hebrejtë kishin një festë të quajtur “pashkë”, që përkujtonte kalimin e Zotit tej shtëpive të tyre kur ai solli plagën e dhjetë mbi egjiptianët (shiko Eksodi 12).

³ Theksi nuk është mbi padenjësinë personale (asnjë nuk është aq i denjë sa të marrë pjesë), por në mënyrën në të cilën marrim pjesë. Të marrësh pjesë “padenjësisht” do të thotë se, ndërsa marrim pjesë në Darkën e Zotit, nuk mendojmë për sakrificën e Jezusit dhe zemra jonë nuk është plot mirënjohje.

⁴ Shiko gjithashtu te Mateu 26:26–29; Marku 14:22–25; Luka 22:19, 20.

⁵ Në festën e Pashkëve përdorej vetëm bukë pa maja (shiko te Eksodi 12:15).

⁶ Shiko te Mateu 26:29; Marku 14:25; Luka 22:18.

⁷ Në kundërshtim me modelin e Dhjatës së Re.

⁸ Në Dhjatën e Re shprehja “thyerja e bukës” mund t'i referohet edhe një vakti të zakonshëm buke. Konteksti përcakton nëse flitet për një vakt të zakonshëm buke apo për Darkën e Zotit.

⁹ Nuk e dimë me saktësi se çfarë u tha Pali atyre, por dimë se fjala e Perëndisë ishte gjithmonë në gojën e tij. Për një shembull të asaj që ai u tha kristianëve në të njëjtin udhëtim shiko Veprat 20:31, 32.

¹⁰ Është e qartë se predikuesi në radhë të parë duhet të besojë se Bibla është nga Perëndia. Për fat të keq, podiumet e disa sekteve fetare janë plot me njerëz që nuk besojnë se Bibla është e frymëzuar nga Perëndia.

¹¹ Shiko gjithashtu te 1 Timoteut 2:8, 11, 12. Dhjata e Re i lejon gratë të mësojnë në situata të caktuara (Vepart 18:26), por gratë nuk duhet të mësojnë apo të predikojnë kur kisha mblidhet për adhurim.

¹² Një përkufizim i thjeshtë i “amen” është “në të vërtetë”. Nuk është thjeshtë një fjalë për të përfunduar lutjen. Për shembull, në qoftë se jeni dakort me diçka që predikuesi thotë, mund ta tregoni aprovimin tuaj duke thënë “amen”.

¹³ Ky është zakonisht kontribut në para, por mund të jetë edhe kontribut në gjëra të tjera.

¹⁴ Në leximin e parë kjo mund të duket sikur çdo kristian individual duhej të hiqte mënjatë para privatisht. Megjithatë, kjo do të sillte nevojën e asaj që Pali po mendohej të evitonte, mbledhjen e parave kur ai të vinte. Kjo ishte një mbledhje e ndihmave që kisha duhej të bënte (v. 1) që të mos ishte e nevojshme të bëhej mbledhja e tyre kur Pali të vinte (v. 2). Përpjekja për të “vënë mënjatë” duhet të ketë qenë një aktivitet publik i kishës për të vënë paratë në një fond të përbashkët (nganjëherë i quajtur “thesari i kishës”).

¹⁵ Disa mendojnë se, për lexuesit e parë të librit të Hebrejve, kjo “ditë” ishte dita e shkatërrimit të Jeruzalemit nga ushtria romake (viti 70 e. së re).

¹⁶ Duhet shtuar një vërejtje e veçantë për nënat me fëmijë të vegjël. Është e vështirë të adhurohet kur fëmijët janë të vegjël, por mos e lini këtë t'ju pengojë nga pjesëmarrja e rregullt. Bëni ç'është e mundur të adhuronit Perëndinë gjatë shërbimit të adhurimit. Perëndia do të kuptojë dhe ju do t'i rrisni fëmijët “në disiplinë dhe në këshillë të Zotit” (Efesianëve 6:4).

Autor: David Roper

Marrë nga studimi: “Udhëzues për shpëtimin e të gjithëve”

© 2001, 2003 E VERTETA PËR SOT

Të gjitha të drejtat të rezervuara